

**16 dhjetor 2014**

**Konkluzionet per licencime doganore te importeve:**

1. Mbledhja e të gjitha institucioneve dhe kompanive relevante te Kosovës të regjistruara në katër komunat veriore që kanë nevojë për licenca për import të mallrave të kontrolluara do të organizohet më 22 dhjetor 2014 nga ZAMV në mjediset e përshtatshme në Mitrovicën e Veriut. Takimi do të lejojë këto kompani të paraqesin një kërkesë për licencë.
2. Sa i përket konkluzioneve më 5 nëntor 2013, licencat do të lëshohen në përputhje me legjislacionin e Kosovës.
3. Sa i përket konkluzioneve me 17 janar 2013, kompanitë në katër komunat veriore të themeluara para asaj dite nuk kanë nevojë të paraqesin, gjatë aplikimit për licenca, dokumentacionin nga Administrata Tatimore e Kosovës (numrin fiskal, numrin e TVSH), numrin e regjistrimit, kartat e identitetit të Kosovës ose dëshmitë gjyqësore.
4. Kompanitë nga katër komunat veriore, të cilat nuk do të dorëzojnë aplikacionet për licencim për importimin e mallrave të kontrolluara para 31 dhjetor 2014 nuk do të jenë në gjendje të vazhdojnë importimin pas kësaj date, pa dokumentet e duhura të licencimit të lëshuara në përputhje me legjislacionin e Kosovës.
5. Kompanitë nga katër komunat veriore, të cilat dorëzojnë aplikacionet për licencim për importimin e mallrave të kontrolluara para 31 dhjetor 2014 do të jetë në gjendje të vazhdojnë importimin deri në një vendim përfundimtar të nxjerr nga institucioni përkatës i Kosovës dhe të njoftohet kompania.
6. Pala e Beogradit do të paraqes listat e tyre të barnave esenciale (për trajtim te brendshëm dhe te jashtëm të pacientëve ) të përdorura në institucionet publike shëndetësore deri më 22 dhjetor 2014.
7. Afati i fundit për licencimin e barnave të paraqitura nga pala e Beogradit do të zgjatet deri më 30 maj 2015. Licencimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Për të siguruar që barnat të licencohen deri më 30 maj 2014, pala tjetër duhet të paraqesin të gjitha dokumentet sa më shpejt të jetë e mundur, duke përfshirë CPP, me kusht që forma e CPP është dakorduar në përputhje me doganat, dokumentet fito sanitare dhe veterinare.
8. Deri në 30 maj 2015, importi i këtyre barnave do të rregullohet nga regjimi i importeve humanitare të ofruara nga legjislacioni i Kosovës.